

VENDIM
Nr. 12, datë 26.11.2009

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 114 dhe 116 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Afrim Tonuzi lirohet nga detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)